



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 129/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) me seli në Kamenicë, për shkak të vendosjes së tendave në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, kështu që Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Kamenicë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 04.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re dega në Prishtinë me të cilën pretendohet se me datën 04.06.2014 rreth orës 12.00 në qendër të Kamenicës, Fatmir Matoshi i AKR-së në Kamenicë ka fotografuar tendën e LVV në rrugë publike afër bankës Ekonomike, ku sipas parashtruesit të ankesës tendat janë të vendosura në mënyrë ilegale. Më tej parashtruesi thekson se në konsultim me KKZ-në dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike në Kamenicë tendat e vështirësojnë qarkullimin e lirë të njerëzve në rrugë dhe janë të vendosura në kundërshtim me ligjin.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur në cilësinë e provës dy fotografi si dhe deklaratën e dëshmitarit i cili ka deklaruar se ka fotografuar tendat e vendosura në qendër të Kamenicës të Lëvizjes Vetëvendosje.

Zyrtari i lart i KKZ-së në komunën Kamenicë e ka pranuar se është bërë një kërkesë më datë 30.05.2014, nga LVV, por ka theksuar se nuk mban përgjegjësi për asnjë problem që mund të ndodh.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi LVV, për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 06.06.2014 deri në ora 10:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën theksohet se subjekti i lartë përmendur posa ka pranuar kërkesën për përgjigje dhe urdhrin për masat përmirësuese për veprimet e ndaluara gjatë fushatës zgjedhore, ka kontaktuar me shtabin e qendrës të këtij subjekti në Kamenicë dhe janë informuar se aktivitetet e tyre ishin paralajmëruar nga LVV në Kamenicë, kërkesa e tillë ishte dorëzuar me 31.05.2014 me të cilën është njoftuar KKZ-ja lidhur me aktivitetin. Po ashtu në përgjigje të ankesës është theksuar se konform dispozitave ligjore të Nenit 32.6 të LZP-së LVV-ja ika informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e saj për dispozitat e kodit të mirësjelljes të subjekteve politike dhe nevojat për të zbatuar dispozitat e tij. Më tej siç shihet edhe nga dëshmitë e ofruara LVV ja ka ndërmarrë të gjitha masat për të evituar të gjitha shkeljet e mundshme me çka e vërtetojnë edhe me postën elektronike të dërguar qysh para fillimit të fushatës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që në nenin 4.2 të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, lidhur me Fushatën Zgjedhore dhe Njoftimin lidhur me Ngjarjet Politike, theksohet se subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë dhe të mbajë një tubim publik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, duhet që të Zyrta i Lartë Komunal i Zgjedhjeve i asaj Komune (ZLKZ), të dorëzojë formularin e plotësuar të Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik (FNJMTP), më së voni shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara. Në këtë rast PZAP-i, në shqiptimin e gjobës si rrethanë lehtësuese mori se LVV, shkeljet e natyrës së tillë nuk i ka kryer më pare dhe i ka ndërmarr të gjitha masat për evitimin e shkeljes së supozuar.

Prandaj PZAP-i duke u mbështetur në dispozitat ligjore si dhe në arsyet e lartë cekura, konstatoi se subjekti LVV nuk ka marr leje nga organi kompetent komunal në këtë rast ZLKZ-në, për mbajtjen e këtij tubimi dhe vendosjen e tendave por vetëm e kanë bërë një kërkesë për ta paralajmëruar ZLKZ gjë që e bën përgjegjës LVV, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 dhe neni 120.1.c të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 129/2014 më datën 06.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoja e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*